



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2777/ 4 prot

Datë 30.11.2023

V E N D I M
Nr. 1240/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.11.2023, shqyrtoi çështjen me:

- Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me REF-79583-09-12-2023 me objekt: “Blerje kancelari” me fond limit 6,066,666 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 23.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, me Nipt, J72124001N, *Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës Km 10, Tiranë.*
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Kamëz.
Adresa: Bulevardi “Nënë Tereza” nr.492 Kamëz, Tiranë.
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK, me Nipt. L91418502J, *Adresa: Zona Kadastrale nr.8517, Ndërtese 4 kate, Spitallë, Durrës.*
- Operatori ekonomik “Adenis Kastrati” P.F. me Nipt. L51611004I, *Adresa: Rr. Demokracia, Godina Nr.29, kati I, Lagjja 4, Bathore, Kamëz, Tiranë .*

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 13.10.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me REF-79583-09-12-2023 me objekt: “Blerje kancelari” me fond limit 6,066,666 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 23.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

II.2. Në datën 23.10.2023, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 27.10.2023 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave për vlerat pa TVSH si vijon:

1. “Librari Dyrrahu” SHPK	me ofertë 4.000.000 L. pa TVSH	kualifikuar
2. “Adenis Kastrati” P.F	4.108.900	“ kualifikuar
3. “Marketing & Distribution” SHPK	4.177.680	“ kualifikuar
4. “InfoSoft Office” SHPK	4.199.473 ^{.81}	“ kualifikuar

II.4. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton, se më datë 06.11.2023 është publikuar njoftimi i fituesit paraprak për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, ka paraqitur ankesë njëherazi pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me numër ankimi elektronik A/2023/3587 dhe me nr. 2777/2023 prot., datë 09.11.2023 me objekt kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Librari Dyrrahu” SHPK. dhe “Adenis Kastrati” P.F.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 2777/2 prot., datë 10.11.2023 referuar kritereve të cilat operatori ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” SHPK pretendon, se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë “Librari Dyrrahu” SHPK dhe “Adenis Kastrati” P.F.

II.7. Me shkresën nr. 8769/1 prot., datë 15.11.2023 protokolluar me tonën me nr. 2777/3 prot., datë 20.11.2023 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi pjesërisht i ankesës.

Konkretisht, autoriteti kontraktor në vendimin e sipërcituar ka arsyetuar si më poshtë:
Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, pas shqyrtimit të ankesës Arsyeton se:

II.8. Në lidhje me pretendimet se Operatoti ekonomik “**Librari Dyrrahu**” SHPK ka ofertuar me një produkt që nuk i plotëson të gjitha specifikimet teknike të mallit të përcaktuar në shtojcën 5 të DST-ve. Nga ana e OE “Librari Dyrrahu” SHPK është dorëzuar si mostër produkti Letër e markës “COPY 1”, referuar skedës teknike të lëshuar nga prodhuesi, letra COPY 1, nuk i plotëson të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara në DT nga autoriteti kontraktor, konkretisht:

- *Specifikimi teknik Shkëlqimi: 95%-115% i kërkuar ne Dt, nuk është pasqyruar në skedën teknike të lëshuar nga prodhuesi.*
- *Specifikimi teknik Dukshmëria: >94%. i kërkuar ne Dt, ndërkohë referuar skedës teknike të prodhuesit Dukshmëria është 91%.*

- KSHA mori në analizë mostrat e dorëzuara nga OE “Librari Dyrrahu” SHPK. dhe konstatoi se mostra e paraqitur dhe skeda teknike nuk japin informacion në lidhje me Shkëlqimin, ... si edhe në lidhje me Dukshmërinë që është në vlerë min 91% dhe ska vlerë maksimale.

Për këto arsye pretendimet e ankimuesit “Marketing & Distribution” SHPK qëndrojnë.

II. 8.1. Në lidhje me pretendimet e ankimuesit mbi mosplotësim të specifikimeve teknike të mostrave të paraqitura nga Operatorit ekonomik “Adenis Kastrati”P.F. për artikullin nr.69 Sett tavoline lekure minimumi 5 pjesë. Mostra e dorëzuar nuk përmbush specifikimet teknike që seti duhet të ketë minimumi 5 pjesë.

- KSHA mori në analizë mostrat e dorëzuara nga OE “Adenis Kastrati”P.F. dhe konstatoi se OE ka dorëzuar si mostër set tavoline me 4 pjesë, set i cili nuk i përmbush kriteret për kualifikim.

Për këtë arsye pretendimet e ankimuesit “Marketing & Distribution” SHPK qëndrojnë.

II.8.2.Në lidhje me pretendimet e ankimuesit mbi mosplotësim të specifikimeve teknike të mostrave të paraqitura nga Operatorit ekonomik “Adenis Kastrati”P.F. për artikullin nr. 20 “Dosje me qesë me kuti me 80 zarfa plastike me trashësi qesëje 40 micron”, ditën e hapjes mostra nuk ka të specifikuar që është 35-45 mic.

- KSHA mori në analizë mostrat e dorëzuara nga OE “Adenis Kastrati”P.F. dhe konstatoi se mostra e dorëzuar nuk ka informacion në lidhje me sa micron është trashësia e zarfit të brendshëm duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar nga AK.

Për këtë arsye pretendimet e ankimuesit “Marketing & Distribution” SHPK qëndrojnë.

II.8.3. Në lidhje me pretendimet e ankimuesit mbi mosplotësim të specifikimeve tëknike të mostrave të paraqitura nga OE “Adenis Kastrati”P.F. për artikullin nr. 54 Qesë plastike per dokumenta A4 , ditën e hapjes mostra nuk ka të specifikuar që është 100 micron.

- KSHA mori në analizë mostrat e dorëzuara nga OE “Adenis Kastrati”P.F. dhe konstatoi se mostra e dorëzuar nuk ka informacion në lidhje me sa micron është duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar nga AK.

Për këtë arsye pretendimet e ankimuesit “Marketing & Distribution” SHPK qëndrojnë.

Mbi gjithë sa u tha më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesë unanimisht:

VENDOSI

Pranimin pjesërisht të ankesës paraqitur nga ana e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK.

II.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar “Librari Dyrrahu” SHPK dhe “Adenis Kastrati”P.F **nuk kanë** dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Librari Dyrrahu” SHPK SHPK dhe “Adenis Kastrati” P.F., Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Me shkresën nr. 8769/1 prot., datë 15.11.2023 protokolluar me tonën me nr. 2777/3 prot., datë 20.11.2023 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi pjesërisht i ankesës.

Konkretisht, autoriteti kontraktor në vendimin e sipërcituar ka arsyetuar si më poshtë:

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, pas shqyrtimit të ankesës Arsyeton se:

Në lidhje me pretendimet se Operatoti ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK ka ofertuar me një produkt që nuk i plotëson të gjitha specifikimet teknike të mallit të përcaktuar në shtojcën 5 të DST-ve. Nga ana e OE “Librari Dyrrahu” SHPK është dorëzuar si mostër produkti Letër e markës “COPY 1”, referuar skedës teknike të lëshuar nga prodhuesi, letra COPY 1, nuk i plotëson të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara në DT nga autoriteti kontraktor, konkretisht:

- *Specifikimi teknik Shkëlqimi: 95%-115% i kërkuar ne Dt, nuk është pasqyruar në skedën teknike të lëshuar nga prodhuesi.*
- *Specifikimi teknik Dukshmëria: >94%. i kërkuar ne Dt, ndërkohë referuar skedës teknike të prodhuesit Dukshmëria është 91%.*
- *KSHA mori në analizë mostrat e dorëzuara nga OE “Librari Dyrrahu” SHPK. dhe konstatoi se mostra e paraqitur dhe skeda teknike nuk japin informacion në lidhje me Shkëlqimin, ... si edhe në lidhje me Dukshmërinë që është në vlerë min 91% dhe ska vlerë maksimale.*

Për këto arsye pretendimet e ankimuesit “Marketing & Distribution” SHPK qëndrojnë.

III.1.2. Në lidhje me pretendimet e ankimuesit mbi mosplotësim të specifikimeve teknike të mostrave të paraqitura nga Operatorit ekonomik “Adenis Kastrati”P.F. për artikullin nr.69 Sett tavoline lekure minimumi 5 pjesë. Mostra e dorëzuar nuk përmbush specifikimet teknike që seti duhet të ketë minimumi 5 pjesë.

- *KSHA mori në analizë mostrat e dorëzuara nga OE “Adenis Kastrati”P.F. dhe konstatoi se OE ka dorëzuar si mostër set tavoline me 4 pjesë, set i cili nuk i përmbush kriteret për kualifikim.*

Për këtë arsye pretendimet e ankimuesit “Marketing & Distribution” SHPK qëndrojnë.

III.1.3. Në lidhje me pretendimet e ankimuesit mbi mosplotësim të specifikimeve teknike të mostrave të paraqitura nga Operatorit ekonomik “Adenis Kastrati” P.F. për artikullin nr. 20 “Dosje me qesë me kuti me 80 zarfa plastike me trashësi qesëje 40 micron”, ditën e hapjes mostra nuk ka të specifikuar që është 35-45 mic.

- KSHA mori në analizë mostrat e dorëzuara nga OE “Adenis Kastrati” P.F. dhe konstatoi se mostra e dorëzuar nuk ka informacion në lidhje me sa micron është trashësia e zarfit të brendshëm duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar nga AK.

Për këtë arsye pretendimet e ankimuesit “Marketing & Distribution” SHPK qëndrojnë.

III.1.4. Në lidhje me pretendimet e ankimuesit mbi mosplotësim të specifikimeve teknike të mostrave të paraqitura nga OE “Adenis Kastrati” P.F. për artikullin nr. 54 Qesë plastike per dokumenta A4 , ditën e hapjes mostra nuk ka të specifikuar që është 100 micron.

- KSHA mori në analizë mostrat e dorëzuara nga OE “Adenis Kastrati” P.F. dhe konstatoi se mostra e dorëzuar nuk ka informacion në lidhje me sa micron është duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar nga AK.

Për këtë arsye pretendimet e ankimuesit “Marketing & Distribution” SHPK qëndrojnë.

Mbi gjithë sa u tha më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesë unanimisht:

VENDOSI

Pranimin pjesërisht të ankesës paraqitur nga ana e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK.

III.1.5. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera”.

III.1.6. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

III.1.7. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se, operatorët ekonomikë të interesuar “Librari Dyrrahu” SHPK dhe “Adenis Kastrati”P.F **nuk kanë** dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike dhe për këtë fakt bazuar në nenin 115 pika a/ii të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.1.8. Sa më sipër, në kushtet kur autoriteti kontraktor ka pranuar një pjesë të pretendimeve të palës ankimese mbi kundërshtim të kualifikimit të dy operatorëve ekonomikë “Librari Dyrrahu” SHPK dhe “Adenis Kastrati”P.F, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, pretendimet e tjera nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative, pasi gjendja faktike dhe juridike e operatorëve ekonomikë “Librari Dyrrahu” SHPK dhe “Adenis Kastrati”P.F do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimesit.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me REF-79583-09-12-2023 me objekt: “Blerje kancelari” me fond limit 6,066,666 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 23.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Autoriteti Kontraktor të skualifikojë operatorët ekonomikë “Librari Dyrrahu” SHPK dhe “Adenis Kastrati” P.F sipas vendimmarjes së autoritetit kontraktor dërguar pranë

Komisionit të Prokurimit Publik me shkresën nr. 8769/1 prot., datë 15.11.2023 protokolluar me tonën me nr. 2777/3 prot., datë 20.11.2023.

4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

